

VENDIM
Nr. 79, datë 26.11.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
ROSKOVEC**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 26.11.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 53, datë 23.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec” pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 165 prot., datë 29.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Roskovec kishte mangësi:

- “Seanca Dëgjimore me Publikun”, nuk ishte zhvilluar konform udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore ku të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ERRU-së.

- “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë, me shkresën nr. 336/1 prot., datë 23.7.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Roskovec, me shkresë nr. 226 prot., datë 21.9.2018 ka njoftuar ERRU-në për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me Publikun dhe me shkresë nr. 237 prot., datë 10.10.2018 ka dërguar procesverbalin e zhvillimit të saj.

Shoqëria UK Roskovec ka dërguar, me shkresën nr. 253 prot., datë 5.11.2018 dokumentin e munguar “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave”, protokolluar në ERRU, me shkresë nr. 459 prot., datë 13.11.2018.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Roskovec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Roskovec për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetës-Kanalizime Roskovec për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani